



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI

Nr. 716/8 Prot.

Tiranë, më 26.11.2025

V E N D I M

Nr. _____, datë ____ . ____ . 2025

Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi¹, bazuar në nenin 32, pika 1, gërma “a”, të ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”², të ndryshuar, mori në shqyrtim ankesën nr. 104 Regj, datë 02.05.2025, paraqitur nga ankuesi z. F.C kundër Komisariati i Policisë Pogradec dhe Drejtorisë të Policisë Korçë, me pretendimin se është diskriminuar për shkak të “moshës” dhe “aftësisë së kufizuar”. Në përfundim të shqyrtimit të ankesës, Komisioneri,

K O N S T A T O I:

I. Parashtrimi i fakteve sipas subjektit ankues.

Në ankesën e depozituar pranë Komisionerit, ankuesi z. F.C parashton:

“Problemi im qëndron se i jam drejtuar Drejtorisë së Policisë Korçë dhe Komisariatit të Policisë Pogradec, lidhur me procedurat e gabuara në kundërshtim me ligjin, për detyrimin ligjorë që kanë drejt meje F.C.Unë i jam drejtuar Policisë së Pogradecit dhe Drejtorisë Korçë në datë 04.03.2025, duke i dhënë fakte, prova dhe vendime të Gjykatës së Shkallës së Parë dhe Gjykatës së Apelit, ku kam qartësuar anën juridike, institucionale dhe njerëzore për pronën time të marrë konform ligjit, kushtetutës dhe të drejtave të mia.

Drejtoria e Policisë Korçë më datë 11.04.2025 më dërgon një shkresë ku shoh veprime të gabuara dhe veprime që shkelin me këmbë vendimin e gjykatës dhe të drejtave të mia. Me veprime dhe mosveprime Policia e Shtetit është e lidhur plotësisht me këtë krim.Ky diskriminim e ka prejardhjen nga mosha dhe invaliditeti im.”

¹ Në vijim do t'i referohemi me shkurtesën Komisioneri.

² Në vijim do t'i referohemi me shkurtesën LMD.

II. Ndjekja e procedurës për shqyrtimin e ankesës nga Komisioneri.

Komisioneri mori në shqyrtim ankesën bazuar në kompetencën e parashikuar nga neni 32, pika 1, gërma “a”, të LMD, që i jep të drejtën për të shqyrtuar ankesat nga personat ose grupet e personave që pretendojnë se janë diskriminuar, sipas parashikimeve të këtij ligji.

LMD, rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë dhe mosdiskriminimit, bazuar në një listë të hapur shkaqesh, duke parashikuar shprehimisht shkaqet e moshës dhe aftësisë së kufizuar, duke përcaktuar në nenin 1, të tij se: *“Ky ligj rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë dhe mosdiskriminimit në lidhje me racën, etninë, ngjyrën, gjuhën, shtetësinë, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, gjininë, identitetin gjinor, orientimin seksual, karakteristikat e seksit, jetesën me HIV/AIDS, shtatzëninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicionet gjenetike, pamjen e jashtme, aftësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë, ose me çdo shkak tjetër.”*

Bazuar në nenin 3, pika 1, të LMD, diskriminimi përcaktohet si : *“çdo dallim, përjashtim, kufizim apo preferencë, bazuar në cilindo shkak të përmendur në nenin 1 të këtij ligji, që ka si qëllim apo pasojë pengesën apo bërjen e pamundur të ushtrimit në të njëjtën mënyrë me të tjerët, të të drejtave e lirive themelore të njohura me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, me aktet ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë, si dhe me ligjet në fuqi.”*

Mbrojtja nga diskriminimi, sipas nenit 7, të LMD, të ndryshuar, garantohej ndaj çdo veprimi ose mosveprimi të autoriteteve publike ose personave fizikë a juridikë që marrin pjesë në jetën dhe sektorët publikë ose privatë, që krijojnë baza për mohimin e barazisë ndaj një personi ose grupi personash, ose që i ekspozon ata ndaj një trajtimi të padrejtë dhe jo të barabartë, kur ata ndodhen në rrethana të njëjta ose të ngjashme, në krahasim me persona të tjerë ose grupe personash.

Në zbatim të parashikimeve ligjore, të neneve 32 dhe 33, të LMD, të ndryshuar, Komisioneri ka shqyrtuar çështjen duke ndërmarrë hapat si më poshtë:

1. Me shkresën nr. 716/1 prot., datë 22.05.2025, Komisioneri njoftoi palët, për fillimin e procedurës administrative, duke kërkuar parashtrime dhe informacion në lidhje me çështjen.
2. Me shkresën nr.4320/1 prot., datë 30.05.2025, ka kthyer përgjigje Drejtoria Vendore e Policisë Korçë, duke parashtruar ndër të tjera se:

Shtetasi F.C, është banor i fshatit Leshnicë, Njësia Administrative Çërravë, Bashkia Pogradec. Që nga viti 2006, ankuesi ka patur konflikt pronësie me shtetasin R.Sh, banues në fshatin Stropckë, Njësia Administrative Dardhas, Bashkia Pogradec, për një sipërfaqe toke, ku palët pretendojnë se i përket secilit prej tyre. Shtetasi R.Sh, e ka përfituar pronësinë mbi tokën në bazë të ligjit nr.7501,

ndërsa ankuesi F.C të njëjtën tokë e ka përfituar me AMTP nr.6381/R, datë 18.04.2005, sipas ligjit nr.8312, datë 21.12.1998 “Për tokat bujqësore të pandara”.

Si ankuesi F.C, por edhe shtetasi R.Sh, kanë disponuar Akt të Marrjes së Tokës në Pronësi, në të njëjtën sipërfaqe toke dhe me vendodhje në të njëjtën zonë kadastrale. Zona kadastrale ku ndodhet toka arë i përket Njesisë Administrative Dardhas dhe jo Njesisë Administrative Çërravë, ku është banor ankuesi F.C dhe këtu ka lindur problematika edhe midis institucioneve që kanë trajtuar rastin në atë kohë.

Shtetasi F.C, ka ushtruar të drejtën për ta ndjekur çështjen gjyqësisht, me qëllim për të përfituar të drejtën e pronësisë mbi tokën arë objekt konflikti. Me vendimin nr.(1385) – 901, datë 06.12.2010, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Pogradec, i ka kërkuar Njesisë Administrative Çërravë që të trajtojë ankuesin F.C, me tokën arë që njëkohësisht e ka përfituar edhe shtetasi R.Sh, pasi kjo tokë sipas tapive të vjetra i përket fshatit Leshnicë, Njësia Administrative Çërravë. Njësia Administrative Çërravë pas administrimit të vendimit të gjykatës me shkresën nr.668, datë 09.10.2012, nisur nga fakti që për të njëjtën tokë arë janë lëshuar dy akte të marrjes së tokës në pronësi, në bazë të ligjit nr. 9948, datë 07.07.2008 “Për shqyrtimin e vlefshmërisë ligjore të titujve në pronësi”, i ka kërkuar “Komisionit vendor të verifikimit dhe vlerësimit të titujve të pronësisë”, pranë institucionit të Prefektit Korçë, që të shprehet se cili nga aktet/titujt e pronësisë është i vlefshëm.

Ankuesi F.C, në datën 05.01.2015, ka aplikuar pranë Zyrës Vendore të Regjistrimit të Pasurive, Pogradec, që të pajiset me certifikatë pronësie për pasurinë e fituar me AMTP nr.6381/R, datë 18.04.2005, sipas ligjit nr.8312 “Për tokat bujqësore të pandara”, duke i bashkëlidhur aplikimit edhe dokumentet që lidhen me këtë pronë. Ish Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurive, Pogradec aktualisht ASHK, nuk ka regjistruar pasurinë, tokë arë në emrin e ankuesit F.C për mungesë dokumentacioni. Nisur nga fakti i mosregjistrimit të pasurisë tokë arë në emrin e ankuesit F.C, ky i fundit ju është drejtuar disa institucioneve, përfshi edhe Drejtorinë Vendore të Policisë Korçë dhe Komisariatit të Policisë Pogradec, duke kërkuar zgjidhje përfundimtare të çështjes së tij.

Bazuar në ankesat e përsëritura të shtetasit F.C, në periudha të ndryshme, i është marrë kallëzim ankuesit dhe materialet i janë përcjellë Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Pogradec dhe Korçë. Më konkretisht:

- Më datën 02.06.2011, shtetasi F.C ka bërë kallëzim ndaj punonjësve të Njesisë Administrative Çërravë, V.J, Z.M, si dhe ndaj shtetasit R.Sh, duke pretenduar se duke shpërdoruar detyrën dhe nëpërmjet falsifikimit të dokumenteve i kanë përvetësuar pronës e tij, tokë arë. Materialet janë referuar në prokurori për veprat penale “Shpërdorimi i detyrës” dhe “Falsifikimi i dokumenteve”, parashikuar nga nenet 248 dhe 186 të K.Penal.
- Më datën 07.05.2012, mbi kallëzimin e shtetasit F.C janë referuar materialet në Prokurori për veprën penale “Shpërdorim i detyrës” parashikuar nga neni 248, në ngarkim të shtetasit A.D

atëherë me detyrë Drejtor i Zyrës Përmbarimore Korçë, ndaj të cilit F.C kishte pretendime se nuk i kishin zbatuar një vendim të formës së prerë të gjykatës.

- Më datë 03.05.2024, shtetasi F.C ka bërë kallëzim ndaj shtetasit RR.Sh, duke pretenduar se ky i fundit me vetëgjyqësi shfrytëzon tokën për të cilën ankuesi pretendon se është pronar.

Në shumë raste ankuesit F.C, i është sugjeruar që ti drejtohet institucioneve përkatëse për zgjidhjen e rastit sikurse është ASHK, Drejtoria Vendore Pogradec, pasi dukshëm trajtimi dhe zgjidhja përfundimtare e çështjes nuk ka të bëjë drejtpërdrejtë me fushën e përgjegjësisë së Policisë së Shtetit.

Ankesa e fundit e shtetasit F.C, drejtuar Drejtorisë Vendore të Policisë Korçë, është ajo e datës 04.03.2025, protokolluar me tonën Nr.F-126, nëpërmjet të cilës ankohet për ish punonjës policie në Sektorin e Hetimit të Krimit Ekonomik dhe Financiar, në Drejtorinë Vendore të Policisë Korçë dhe Komisariatit të Policisë Pogradec, që sipas tij i kanë hequr të drejtën e pronës.

Meqenëse ankesa e këtij shtetas ka qenë e përsëritur, duke u nisur edhe nga përmbajtja e ankesës e cila duket qartë që nuk ka të bëjë drejtpërdrejtë me fushën e përgjegjësisë së Policisë së Shtetit, i është kthyer përgjigje ankuesit duke i sugjeruar që ankesën t'ia drejtojë institucioneve të cilat ndjekin, trajtojnë dhe zgjidhin çështjen e pronësisë.

Referuar shkresës nr. 661/1 prot., datë 17.04.2020, të ASHK, Drejtoria Vendore Pogradec, kopje të së cilës ankuesi F.C e ka dërguar bashkëlidhur ankesës së datës 04.03.2025, rezulton se lidhur me trajtimin e rastit janë angazhuar shumë institucione, përfshi edhe Ministrinë e Drejtësisë, e cila me shkresën nr.2951, datë 09.08.2018, ka rekomanduar që *“ZVRPP Pogradec, aktualisht ASHK, të vazhdojë trajtimin e kërkesës për regjistrim pasurie për shtetasin F.C vetëm pasi KVVTP Korçë, të shprehet lidhur me vlefshmërinë ligjore të AMTP nr.6381/R, datë 18.04.2005”*.

Nisur nga sa më sipër, duke qenë se Drejtoria Vendore e Policisë Korçë, ka përmbushur detyrimet e saj ligjore sa herë që ankuesi F.C ka bërë kallëzim pranë institucionit tonë dhe materialet i janë përcjellë prokurorisë, në datën 11.04.2025, i është kthyer përgjigje duke i sugjeruar që lidhur me çështjen ti drejtohet institucioneve të cilat ndjekin, trajtojnë dhe zgjidhin çështjet e pronësisë.

Referuar trajtimit të ankesave të shtetasit F.C në kohë të ndryshme, por edhe trajtimit të ankesës së datës 04.03.2025, gjykojmë se në asnjë rast ankuesi F.C nuk është diskriminuar për shkak të moshës dhe aftësisë së kufizuar nga punonjësit e policisë që kanë trajtuar rastin apo kanë kryer veprime procedurale.

Në përgjigjen kthyer ankuesit F.C, me tonën F-126/1, datë 11.04.2025, nuk janë përmendur çështje që lidhen me diskriminimin për çfarëdo lloj arsye dhe nuk është diskutuar asnjë lloj vendim marrje e gjykatës apo institucioneve të tjera. Materialet bashkëlidhur ankesës së shtetasit F.C në datën 04.03.2025 nuk përbëjnë ndonjë provë që të vërtetojnë veprim të kundraligjshëm nga punonjësit e policisë, emrat e të cilëve i përmend në ankesë.

3. Me shkresën nr.1211/1 prot., datë 28.05.2025 (administruar pranë Komisionerit me nr. 716/2 prot datë 30.05.2025), ka kthyer përgjigje në lidhje me ankesën Komisariati i Policisë Pogradec, duke parashtruar ndër të tjera:

Nga verifikimet e kryera, shtetasi F.C, banues në fshatin Leshnicë, Njësia Administrative Çërravë, Pogradec, është paraqitur shumë herë në Komisionarin e Policisë Pogradec dhe sa herë është paraqitur, është vlerësuar rasti duke përpiluar materialet procedurale të cilat janë referuar në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Korçë dhe disa prej rasteve jua paraqesim si më poshtë:

Në datë 02.06.2011, ora 08:00, filloi procedimi penal ndjekje në gjendje të lirë për shtetasit V.J, Kryetar i Komunës Çërravë, R.Sh, Z.M, ish punonjës i Komunës Çërravë, bazuar në kallëzimin e shtetasit F.C, i cili ka pretenduar se shtetasit e mësipërm nëpërmjet shpërdorimit të detyrës dhe falsifikimit të dokumenteve në bashkëpunim, i kanë përvetësuar një sasi toke këtij shtetasi. Materialet i kaluan Prokurorisë Pogradec për ndjekje të mëtejshme. Vepra penale “Shpërdorim i detyrës”, “Falsifikim i dokumenteve”, parashikuar nga neni 186 dhe 248 të K.Penal.

Në datë 07.05.2012, ora 08:00, filloi procedimi penal ndjekje në gjendje të lirë për shtetasin A.P K, punonjës në Zyrën e Përmbartimit Korçë, sepse po në këtë datë, ka bërë kallëzim shtetasi F.C, i cili deklaroi se ky shtetas, nuk ka ekzekutuar një vendim të formës së prerë të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Pogradec. Vepra penale “Shpërdorim detyre” neni 248 K.Penal.

Me datë 03.05.2024, u referuan materialet në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Korçë, për shtetasin RR.Sh, mbi bazën e kallëzimit të shtetasit F.C, se në tokën me nr.pasurie nr.113/31, në fshatin Leshnicë, e cila pretendohet nga të dyja palët, shtetasi i mësipërm me vetëgjyqësi e ka shfrytëzuar duke e punuar dhe mbjelle këtë pronë. Neni 277 i K.Penal.

Gjithashtu, ka pasur ankesa të vazhdueshme dhe për këto ankesa i janë kthyer përgjigje nga ana e Komisionarit të Policisë Pogradec.

Në bazë të shkresës të dërguar nga ana juaj lidhur me ankesën e shtetasit F.C nga ana e Komisionarit të Policisë është vlerësuar përsëri rasti duke marrë kontakt me këtë shtetas, i cili ka dhënë deklaram për pretendimet që ka dhe materialet janë referuar në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Korçë, për vlerësim.

4. Bazuar në nenin 33/8, të LMD, ku parashikohet: “Kur e sheh të përshtatshme, komisioneri zhvillon një seancë dëgjimore publike dhe fton palët dhe çdo person tjetër të interesuar”, për të sqaruar të gjitha faktet dhe rrethanat e çështjes, Komisioneri me shkresën nr. 716/5 prot., datë 06.08.2025, njoftoi palët për zhvillimin e një seance dëgjimore në datën 19.08.2025.

Seanca dëgjimore u zhvillua në datën 19.08.2025, me pjesëmarrjen e palës ankuese z. F.C dhe Drejtorisë Vendore të Policisë Korçë dhe Komisionarit të Policisë Pogradec, përfaqësuar nga z. T.G,

specialist jurist në Sektorin e Burimeve Njerëzore në Drejtorinë Vendore të Policisë Korçë, sipas autorizimit nr.2554 prot., datë 15.08.2025.

III. Vlerësimi i fakteve dhe provave të grumbulluara nga Komisioneri gjatë procesit të shqyrtimit të çështjes.

A. Lidhur me trajtimin e padrejtë, të pabarabartë dhe të pafavorshëm.

Bazuar në provat e administruara gjatë shqyrtimit të ankesës rezultoi e provuar se, ankuesi F.C, i datëlindjes 29.09.1947, është banor i fshatit Leshnicë, Njësia Administrative Çerravë, Bashkia Pogradec. Që nga viti 2006, ankuesi ka patur konflikt pronësie me shtetasin R.Sh, banues në fshatin Stropckë, Njësia Administrative Dardhas, Bashkia Pogradec, për një sipërfaqe toke, ku palët pretendojnë se i përket secilit prej tyre.

Ankuesi F.C, ka ushtruar të drejtën për ta ndjekur çështjen gjyqësisht, me qëllim për të përfituar të drejtën e pronësisë mbi tokën arë objekt konflikti. Me vendimin nr.1385 – 901, datë 06.12.2010, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Pogradec, ka disponuar se sipërfaqja e tokës, pronësia e të cilës pretendohet si nga ankuesi ashtu edhe nga shtetasi R.Sh, ndodhet në fshatin Leshnicë Pogradec dhe ka juridiksion territorial Komunën Çerravë Pogradec.

Ankuesi F.C, ka aplikuar pranë Zyrës Vendore të Regjistrimit të Pasurive, Pogradec aktualisht Agjencia Shtetërore e Kadastrës (ASHK) që të pajiset me certifikatë pronësie, por nuk ka mundur të regjistrojë pasurinë, tokë arë. Nisur nga fakti i mosregjistrimit të pasurisë tokë arë ankuesi i është drejtuar disa institucioneve, Ministrisë së Drejtësisë, ish Zyrës Qëndrore të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme, aktualisht Agjencia Shtetërore e Kadastrës (ASHK), ish- Zyrës Vendore të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Pogradec, Avokatit të Popullit, Kryeministrisë, përfshi edhe Drejtorinë Vendore të Policisë Korçë dhe Komisariatit të Policisë Pogradec, duke kërkuar zgjidhje përfundimtare të çështjes së tij.

Nga aktet e administruara rezulton se, ndër vite duke filluar nga viti 2011, ankuesi ka bërë disa kallëzime penale kundrejt personave të cilët sipas tij e kanë cenuar në të drejtën e pronës, të cilat i ka parqitur pranë Komisariatit të Policisë Pogradec dhe Drejtorisë Vendore të Policisë Korçë.

Ankuesi ka depozituar pranë Drejtorisë Vendore të Policisë Korçë ankesën e cila është administruar pranë këtij institucioni me nr. F-126, datë 04.03.2025, në të cilën ankuesi pretendon se punonjës të Komisariatit të Policisë Pogradec, për shkak të korrupsionit, i kanë cenuar të drejtën e pronës, pasi nuk ndërmarrin veprime ndaj peronit që i cenon pronën e tij.

Me shkresën nr. F-126/1 prot., datë 11.04.2025 me lëndë “*Kthim përgjigje në lidhje me ankesën e shtetasit F.C*”, Drejtoria Vendore e Policisë Korçë, i ka kthyer përgjigje ankuesit, duke e informuar se: “ *....përmbajtja e ankesës suaj ka karakter civil dhe për shkak se ju keni bërë disa herë kallëzim penal në Drejtorinë Vendore të Policisë Korçë, materialet janë referuar në Prokurorinë pranë*

Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Korçë. Ankesa që drejtoni ju, ka të bëjë me të drejtën e pronësisë tuaj dhe për këtë çështje duhet ti drejtoheni organeve të Qeverisjes Vendore dhe Gjykatave, sipas juridiksionit përkatës.”

Me shkresën nr. 1106 prot., datë 27.05.2025, Komisariati i Policisë Pogradec, ka dërguar materialet procedurale për “Vlerësim”, konkretisht : informacion referimi, procesverbalin e deklarimit të F.C dhe procesverbal kqyrje prove materiale, në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Korçë.

Ankuesi ka paraqitur pranë Komisionerit ankesën objekt shqyrtimi duke pretenduar se është diskriminuar për shkak të moshës dhe aftësisë së kufizuar nga ana e Drejtorisë Vendore të Policisë Korçë dhe Komisarariatit të Policisë Pogradec.

Gjatë shqyrtimit të ankesës, Drejtoria Vendore e Policisë Korçë dhe Komisariati i Policisë Pogradec, pretenduan se kanë përmbushur detyrimet ligjore sa herë që ankuesi F.C ka bërë kallëzim pranë tyre dhe materialet i janë përcjellë prokurorisë.

Në lidhje me ankesën e fundit që ankuesi ka depozituar, DVP Korçë, parashtrohet se, në datën 11.04.2025, i është kthyer përgjigje ankuesit duke i sugjeruar që lidhur me çështjen ti drejtohet institucioneve të cilat ndjekin, trajtojnë dhe zgjidhin çështjet e pronësisë, duke qenë se ankesa e tij ishte e përsëritur, ndërsa Komisariati i Policisë Pogradec, në datën 27.05.2025 ka përcjellë materialet procedurale për vlerësim, në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Korçë.

Nga aktet e administruara rezulton se në datën 03.05.2024, mbi bazën e kallëzimit të ankuesit, janë referuar materialet në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Korçë. Në datën 08.05.2024, mbi bazën e materialit të referuar nga Komisariati i Policisë Pogradec, Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Korçë, ka regjistruar kallëzimin nr.831. Në datë 20.05.2024, prokuroria ka vendosur mosfillimin e procedimit penal për kallëzimin nr.831, duke arsyetuar se nga tërësia e veprimeve të kryera lidhur me materialin kallëzues, nuk konstatohet ekzistenca e elementëve të ndonjë vepre penale, por personat e përfshirë në konflikt duhet të zgjidhin në rrugë administrative apo gjyqësore civile, problematikat e pronësisë mbi pasurinë objekt konflikti.

Në bazë të ligjit Nr. 82/2024 “Për Policinë e Shtetit”, i cili është aktualisht në fuqi por edhe ligjit të mëparshëm nr.108/2014 “Për Policinë e Shtetit”, i ndryshuar, përgjegjësitë dhe funksionet e e Policia e Shtetit janë, mbrojtja e jetës dhe shëndetit të personave, garantimi i paprekshmërisë së pronës publike dhe private, marrja, trajtimi dhe referimi pranë strukturave përgjegjëse të ankesave e shtetasve, në mënyrë të veçantë, kallëzimet penale.

Nga aktet e administruara, rezulton se, ankuesi nuk rezulton që të ketë regjistruar pranë autoritetit përgjegjës për regjistrimin e pasurive të paluajtshme aktualisht ASHK, titullin e pronësisë, Aktin e

Marrjes së Tokës në Pronësi, mbi bazën e të cilit ai pretendon të drejtën e pronësisë mbi tokën arë dhe të jetë pajisur me certifikatë pronësie. Në lidhje me të njëjtën sipërfaqe toke, rezulton se edhe shtetasi R.Sh, zotëron një titull pronësie, Aktin e Marrjes së Tokës në Pronësi.

Sa më sipër, Komisioneri e gjen të bazuar pretendimin e DVP Korçë dhe Komisariatit të Policisë Pogradec, se nuk është në fushën e përgjegjësisë së policisë së shtetit zgjidhja e konfliktit të pronësisë që ankuesi parashtron nëpërmjet ankesave të paraqitura pranë këtyre dy institucioneve. Nga tërësia e akteve të administruara, Komisioneri konstaton se, DVP Korçë dhe Komisariatit të Policisë Pogradec, kanë përmbushur detyrimet ligjore sa herë që ankuesi F.C ka bërë kallëzim.

Për sa më lart, përfundimisht Komisioneri vlerëson se, ankuesi F.C, nuk i është nënshtruar një trajtimi të padrejtë, të pafavorshëm dhe të pabarabartë nga ana e Drejtorisë Vendore të Policisë Korçë dhe Komisariatit të Policisë Pogradec. Në mungesë të trajtimi të padrejtë, të pafavorshëm dhe të pabarabartë, Komisioneri arrin në përfundimin që nuk kemi të bëjmë me një sjellje diskriminuese dhe shkelje të dispozitave të ligjit nr.10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar nga ana e subjekteve kundër të cilëve është paraqitur ankesa.

PËR KËTO ARSYE :

Bazuar në nenin 32 dhe 33, të ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, i ndryshuar, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

V E N D O S I :

1. Konstatimin e mosdiskriminimit të ankuesit F.C nga ana e Drejtorisë Vendore të Policisë Korçë dhe Komisariatit të Policisë Pogradec, për shkaqet e pretenduara prej tij.
2. Kundër këtij vendimi lejohet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda 45 ditëve nga marrja dijeni.

KOMISIONER

Robert GAJDA

Shkaku: Mosha, Aftësia e kufizuar
Fusha: Shërbime
Lloji i vendimit: Mosdiskriminim